



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Agjenda e Reformave të Kosovës në kuadër të Instrumentit të BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike në Ballkanin Perëndimor.
2. Buxheti për zbatimin e Agjenda e Reformave të Kosovës, si dokument planifikues shumëvjeçar, është brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për periudhën përkatëse dhe në pajtim me Kornizën Afatnesme të Shpenzimeve.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, sipas Agjendës së Reformave të Kosovës, që të zbatojnë këtë vendim.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që t'ia përcjellë Agjendën e Reformave të Kosovës Komisionit Evropian për informim dhe procedura të mëtejshme të parapara me rregulloret përkatëse të Instrumentit të BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike në Ballkanin Perëndimor.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet: 216, 218 dhe 220 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 217 dhe 219 elektronike /korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/223

Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Lëndët Plasëse.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Shërbimet e Pagesave.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/223

Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/223

Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/I.-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji Kundër Dukurive Negative në Sport.
2. Projektligji nga pika 1. c këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/223

Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Standardet, Metodologjinë dhe Sistemin e Hartimit dhe Monitorimit të Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal të Rajoneve Zhvillimore.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 39 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 53 paragrafit 3. të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:


V E N D I M

Për Anulimin e pjesshëm të Vendimit Përfundimtar Nr.07/95 të datës 26 mars 2019

1. Anulohen nga Vendimi Përfundimtar Nr.07/95 i datës 26 mars 2019, parcelat si më poshtë:
 - Parcela Nr.433-1 e paraqitur në rreshtin Nr. 53 tabela për zonën kadastrale Talinoc i Jerlive, Komuna Ferizaj;
 - Parcela Nr.5-1 e paraqitur në rreshtin Nr.1 tabela për zonën kadastrale Fshati i Vjetër, Komuna Ferizaj;
 - Parcela Nr.5-2 e paraqitur në rreshtin Nr.13 tabela për zonën kadastrale Fshati i Vjetër, Komuna Ferizaj.
2. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPHI, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPHI bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Themelimin, Organizimin, Funksionimin dhe Monitorimin e Qendrave për Zhvillim Rajonal në Rajonet Zhvillimore.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/223
Datë: 09.10.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Ndërtimi i Krugës Rajonale R221 Cerkolez-Rakosh, zonat kadastrale: Cerkolez, Rakosh, Suhogërrllë dhe Uçë, Komuna Istog, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi janë raportet e vlerësimit të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjislacionit në fuqi.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/223

Datë: 09.10.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi dhe krijimi i të drejtës së servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: "Ndërtimi Nënstacionit NS 220/35/10(20) kV Malisheva dhe Linja Transmetuese 220 kV Dragobil", në Qytetin e Malishevës, zona kadastrale: Dragobil, Komuna Malishevë në dobi të Subjektit Kërkues/Kompania KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.), sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi janë raportet e vlerësimit të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues/Ndërmarrja Publike Qendrore KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.), do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjislativ në fuqi.
8. Subjekti Kërkues-Ndërmarrja Publike Qendrore KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.), do të paguajë plotësisht të gjitha obligimet tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimet gjyqësore.
9. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

- Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit për nevoja të Terminaleve Doganore: Hani i Elezit, Komuna Ilani i Elezit dhe Dheu i Bardhë, ZK Domoroc, Komuna Ranillugë, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
- Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
- Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarikë në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
- Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Subjekti Kërkues/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/223
Datë: 09.10.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N2 Segmenti "Hyrja në Qytetin e Ferizajt", zonat kadastrale: Perlez i Jerlive, Muhoc, Talinoc i Jerlive, Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj dhe Fshati i Vjetër, Komuna Ferizaj, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafit 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/223

Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Ndërtimi i Rrugës Rajonale R-118 Mushtisht-Shtërpcë, zonat kadastrale: Delloc, Komuna Suharekë dhe Vërbeshicë, Komuna Shtërpcë, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Vlerësimi i pronave të paluajtshme do të bëhet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafit 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Ndërtimi i "Qarkores së Jashtme të Qytetit të Gjilanit dhe Kycja e Rrugës Nacionale N25.2 dhe N25.3 deri te Autoudha R7.1" zonat kadastrale: Velekincë, Gjilan, Livoç i Ultë dhe Livoç i Epërm, Komuna Gjilan, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Vlerësimi i pronave të paluajtshme do të bëhet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafit 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 18/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit Lokal, kryesues;
 - 1.2. Ilir Muçaj, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar;
 - 1.3. Bekim Hoxha, Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari, anëtar;
 - 1.4. Marslinda Byçi, Udhëheqëse e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, anëtare dhe
 - 1.5. Vehbi Ramaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar.
- Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Qeverisë Nr. 06/212 i datës 10 korrik 2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 19/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese: Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, në këtë përbërje:
 - Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kryesuese;
 - Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - Bekim Hoxha, Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, anëtar;
 - Lumnije Krasniqi, U.D. Udhëheqëse e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, anëtare;
 - Esat Aliçkaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar.
- Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Besim Kamberaj, emërohet në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. c këtij vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Rajonal për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/223

Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 36, paragrafit 4. të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 për Shkollimin Specialistik, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesën e 22 (njëzet e dy) specialistëve me vetëfinancim nga Lugina e Preshevës, Republika e Shqipërisë, Republika e Malit të Zi etj. nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nën-programi Aftësimi Specialistik dhe EVM kod 90300, në shumë prej 58,080.00€ (pesëdhjetetëtmijë e tetëdhjetë euro), prej datës 1 tetor 2024 deri më 31 dhjetor 2024.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Institucionet tjera relevante, të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.06/L-079 për Eficiencë të Energjisë, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 29/112 i datës 13 dhjetor 2022 për miratimin e Planit të Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.03/128 të datës 16 shkurt 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike me plotësim/ndryshim nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Pjesët tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 29/112 të datës 13 dhjetor 2022 mbesin të pandryshuara.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Pako Mbështetëse e Energjisë dhe Kontratave dhe Ndërtimit të Qëndrueshmërisë
Plani i Veprimit - Kosovë**

I. Objektiv: Zbutja e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike me fokus në familjet në nevojë dhe palët ekonomike të cenueshme (NMVM-të)

1. Masa: Mbështetje e drejtpërdrejtë financiare për familjet më të cenueshme dhe në disavantazh social për periudhën e dimrit (25 milionë euro) – Masë e menjëhershme

Masa synon të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për periudhën e dimrit për familjet më të cenueshme, që përfshin mbështetje të drejtpërdrejtë për pranuesit e skemave sociale dhe pensionale, si dhe grupet tjera të cenueshme dhe të marginalizuara:

- i. Zgjerimi i numrit të përfuturve të programit aktual të subvencionimit të një pjese të faurës së energjisë për pranuesit e skemave sociale dhe pensionale (aktualisht 4.5 milionë euro të shpenzuara në vit për tu rritur deri në 20 milionë euro ku mbështetja mund të projektohet në nivele të ndryshme për përfutues të ndryshëm);
- ii. Subvencionimi i metodave alternative të ngrohjes ndaj energjisë elektrike (druri, pollet) për grupet e cenueshme dhe të marginalizuara (familjet që marrin ndihmë sociale me fokus në pakicet, prindërit vetshohës, familjet anëtarët e të cilave janë persona me aftësi të kufizuara) - deri në 5 milionë euro

Kjo masë do të zbatohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Shënim: Këto masa mund të zbatohen gjatë vitit 2022 nga buxheti i qeverisë në mënyrë që të kenë efekt të menjëhershëm, atëherë shuma e shpenzuar mund të rimbursohet nga fondet e BE-së kur këto fonde disbusohen gjë e cila kushtëzohet me plotësimin e kushteve të përgjithshme në kohën e kërkesës për pagesë.

Treguesi	Baza	Synimi	Burimi i verifikimit
Numri i familjeve të cenueshme ¹ që përfituan nga masa mbështetëse, e ndarë sipas gjinisë dhe pakicave	40,000 familje të cenueshme sociale, përfshirë 7,000 familje të minoritetit RAE marrin subvencionim mujor për faturen e energjisë elektrike (40 €/ muaj)	200,000 familje të cenueshme (mesatarisht 100€/ muaj)	Raportet me statistika nga MFPT
Numri i familjeve në disavantazh social që kanë përfituar nga masa mbështetëse ii.) të ndara sipas gjinisë dhe pakicës	Deri më sot nuk ka asnjë subvencion për lëndët djegëse të biomasës për familjet në nevojë	10,000 familje në nevojë	Raportet me statistika nga MFPT

¹ Konsumatori i cenueshëm sic përcaktohet në Strategjinë e Energjisë 2017-2025 për Kosovë, gjithashtu Konsumatori në nevojë sic përcaktohet në Ligjin e Kosovës për Rregullatorin e Energjisë, neni 50 dhe në Ligjin për energjinë elektrike, neni 3 dhe neni 49 i cili përcakton që konsumatori në nevojë është konsumatori familjar i cili për shkak të statusit social gëzon të drejtë të veçanta në lidhje me furnizimin me energji elektrike si dhe përcakton elemente të programit për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë.

2. Masa: Nxitja e kursimit të energjisë nga konsumatorët familjar (15 milionë euro) – Masë e menjëhershme

Qëllimi i masës është të nxiten familjet për të reduktuar konsumin e energjisë elektrike përmes subvencionimit të faturave të energjisë elektrike:

- Mbështetja e familjeve duke subvencionuar faturën e muajit aktual të energjisë elektrike bazuar në % e kursimit të energjisë që kanë bërë në krahasim me të njëjtin muaj të një viti më parë. Subvencionimi pasqyrohet në faturën e energjisë elektrike të çdo muaji.

Kjo masë do të zbatohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Shënim: Kjo është një masë e vazhdueshme që po zbatohet nga MFPT gjatë vitit 2022 dhe pilotimi është treguar i suksesshëm.

Treguesi	Baza	Synimi	Burimi i verifikimit
Numri i familjeve që përfituan nga mbështetja, e ndarë sipas gjinisë dhe pakicës	167.571 familje kanë marrë subvencion për energjinë e kursyer për muajin nëntor 2022 krahasuar me nëntor 2021	Rreth 150.000 familje pritet të përfitojnë subvencionim për shkak të kursimit të energjisë elektrike të arritur muaj pas muaji.	Raportet me statistika nga MFPT

3. Masa: Mbështetja e konsumatorëve individual familjar duke përfshirë konsumatorët në nevojë përmes rritjes së efijencës së energjisë në njësitë e banimit dhe ndërtesa (20 milionë euro) – Masë afatshkurtër

Masa synon subvencionimin në formë të granteve për familjet individuale duke përfshirë familjet në nevojë në rinovimin e njërive të banimit me llojin e mëposhtëm të masës së efijencës të energjisë: Mbështetja (izolim) i ndërtesës (fasada e jashtme, dritaret dhe dyert e jashtme).

Grupi i synuar:

- Konsumatorët familjar (grant i dhënë për rinovimin e shtëpive individuale).
- Konsumatorët në nevojë (grant i dhënë për rinovimin e ndërtesave shumë banesore në të cilat banojnë familjet dhe qytetarët nën skemën e ndihmës sociale, ndërtesa të cilat janë në pronësi publike nga komunat).

Kjo masë do të zbatohet duke zgjeruar fushëveprimin e Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE) në sektorin rezidencial. FKEE ka tashmë përvojë në zbatimin e masave të EE në ndërtesat në pronësi publike, por në mënyrë që të zbatohen masat e EE për ndërtesat e banimit gjatë vitit 2023. FKEE do të përforecohet, të paktën për kohëzgjatjen e skemës (stafi do të përfshihet dhe trajnohet).

Shënim: Masa do të monitorohet dhe zbatohet nga FKEE duke përfshirë në aranzhimet organizative edhe të rinj/ të diplomuarit në bashkëpunim me Universitetin e

Prishtinës dhe/ose Agjencinë e Punësimit të Kosovës (deri në 1 milion euro që do të mbulohen nga Qeveria, buxheti që ndahet në baza vjetore për FKEE).

Treguesi	Baza	Objektivi (afatshkurtër dhe afatmesëm)	Burimi i verifikimit
Numri i familjeve (shtëpive individuale) që përfitojnë nga programi i subvencionit të FKEE, i ndarë sipas gjinisë, minoriteteve	Asnjë - FKEE nuk ka filluar ende funksionimin në sektorin rezidencial (2022)	2.000 familje (maksimumi 50% subvencion granti) të ndara sipas gjinisë dhe minoriteteve	Raportet administrative/ Statistikat Raporti i Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)
Numri i konsumatorëve në nevojë (në ndërrasat shumë banesore) që përfitojnë nga programi i subvencionit të FKEE	Asnjë FKEE nuk ka mbështetur sektorin rezidencial dhe as familjet në nevojë në të kaluarën.	25 ndërrasa shumë banesore – 1250 njësi gjithsej me 100% subvencionim/grant të renovuara brenda 2-3 viteve.	Raportet administrative/ Statistikat Raporti i Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) Raportet e Ministrisë së Financave

4. Masa: Mbështetja e konsumatorëve familjarë duke përfshirë konsumatorët në nevojë dhe e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) në investimin në masat e eficiencës së energjisë (15 milionë euro) – Masë afatshkurtër

Qëllimi i masës është të nxisë konsumatorët familjarë si dhe ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme të kursejnë energji elektrike duke u ofruar subvencione për investime në masat e eficiencës së energjisë.

- Grupi i synuar:
- A. Konsumatorët familjarë përfshirë konsumatorët në nevojë;
 - B. Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM-të).

A. Konsumatorët familjarë përfshirë konsumatorët në nevojë:

Masa është e ndarë në tri nënkategori dhe synon të japë subvencione për familjet, duke përfshirë konsumatorët në nevojë me llojin e mëposhëm të masës së eficiencës së energjisë. [Konsumatorët në nevojë përfitojnë nivel më të lartë subvencionit. (p.sh. për konsumatorët në nevojë deri në 90% subvencion për stufat me biomasë dhe 60% për pompat termike ajër-ajër të tipit inverter, krabasuar me 70% dhe 30% subvencionim për familjet e tjera për stufat me biomasë dhe pompat termike ajër-ajër të tipit inverter)].

- Masat e eficiencës së energjisë:
- i. Instalimi i pajisjeve eficiente për ngrohje;
 - ii. Instalimi i pajisjeve shtëpiake eficiente;
 - iii. Instalimi i sistemeve nga BRE-të (Sisteme fotovoltaike solare dhe sisteme diellore për ngrohjen e ujit).

Shënim: Masa është vazhdim i një skeme të ngjashme (me disa ndryshime) të nisur dhe menaxhuar nga Ministria e Ekonomisë gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor 2022 me një shumë totale prej 6 milionë eurosh, e cila rezultoi e suksesshme.

B. Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme.

Qëllimi i masës është të nxisë ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme të kursejnë energji elektrike duke u ofruar subvencione për investime në këto masa të eficientës së energjisë:

- i. Instalimi i pajisjeve eficiente për ngrohje;
- ii. Instalimi i pajisjeve eficiente të punës;
- iii. Instalimi i sistemeve nga BRE-të (Sisteme fotovoltaike solare dhe sisteme diellore për ngrohjen e ujit).

Këto masa do të zbatohen dhe monitorohen nga Ministria e Ekonomisë.

Treguesi		Baza	Objektivi (afatshkurtër dhe afatmesëm)	Burimi i verifikimit
Numri i familjeve përfutuese që përfitojnë nga programi (pajisje ngrohëse, pajisje shtëpiake, sisteme nga BRE-të).	Numri i familjeve përfutuese të ndihmuara aktualisht përmes skemës nga Ministria e Ekonomisë: 3.000	Numri i familjeve përfutuese të ndihmuara aktualisht përmes skemës nga Ministria e Ekonomisë: 3.000	Numri i familjeve përfutuese i rritur nga niveli bazë: 10,000 të ndara sipas gjinisë dhe paktive	Raportet administrative/Statistikat nga Ministria e Ekonomisë
Numri i NMMVM-ve që përfitojnë nga mbështetja	Asnjë.	Asnjë.	540 NMMVM	Raporte me statistika nga Ministria e Ekonomisë

5. Masa: Fushata komunikimi dhe ndërgjegjësimi

Kjo masë synon planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të ndryshme që lidhen me:

1. Rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme;
2. Komunikimin për Pakon Mbështetëse të Energjisë.

Fushata e ndërgjegjësimit lidhur me energjinë do të zbatohet për të theksuar rëndësinë e zbatimit të praktikave të Eficiencës së Energjisë në jetën e përditshme dhe rëndësinë e kalimit drejt sistemeve të ER për të kapërcyer krizën energjetike.

Për të komunikuar në lidhje me Pakon Mbështetëse të Energjisë të financuar nga BE-ja dhe të zbatuar nga Qeveria e Kosovës, një plan komunikimi do të duhet të hartohet deri në vitin 2022 së bashku me BE-në dhe të zbatohet përgjatë viteve 2022-2023. Kjo do t'i japë shikueshmëri pakos, do të promovojë masat e përfshira në pako për të

<p>kërkuar përfitues të mundshëm si dhe do të shpallë publikisht rezultatet e arritura përgjatë vitit 2023.</p> <p>Shënim: Kostoja e parashikuar për çdo masë për edukimin, komunikimin dhe ndërgjegjësimin do të mbulohet nga buxheti i institucioneve zbatuese, me përjashtime të përjashtueshme dhe veprime plotësuese.</p>				
Treguesi		Baza	Objektivi (afatshkurtër dhe afatmesëm)	Burimi i verifikimit
Një fushatë në nivel kombëtar e nisur përmes kanaleve të ndryshme: lajme/ artikuj televizivë	1. Për EE/ BRE tashmë është në zbatim një fushatë e financuar nga Qeveria 2. Për aplikimin e pakos së Energjisë: 0		Reklamat televizive për EE/BRE Reklamat televizive	RTK publike Stacione televizive private Ueb faja e FKKE Ueb faja e Ministrisë së Ekonomisë Ueb faja e FKGGK
Numri i ngjarjeve publike që promovojnë pakon e energjisë dhe rezultatet	0		Të paktën 5 ngjarje duke përfshirë ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit dhe transferimin e kështu të parë (90% e shumës totale)	Ueb faja e FKKE Ueb faja e Ministrisë së Ekonomisë Ueb faja e FKGGK Njoftimi për shtyp
Fushata e mediave sociale				Mediat sociale
II. Objektivi: Krijimi i një strategjie të energjisë së qëndrueshme				
Masa: Miratimi i një strategjie/ plani veprimi afatshkurtër dhe afatmesëm për energjinë e qëndrueshme				
<p>Një sërë strategjish, ligjesh dhe rregulloreesh do të hartohen dhe miratohen gjatë periudhës 2022-2023 me qëllim që të përfshihet strategjia e energjisë së qëndrueshme dhe të mundësohen veprime afatshkurtra dhe afatgjata.</p>				
Treguesi		Baza	Objektivi (afatshkurtër dhe afatmesëm)	Burimi i verifikimit
Miratimi i Strategjisë së Energjisë 2022-2031	Nuk është miratuar asnjë strategji për energjinë përtej vitit 2021.		Strategjia e Energjisë 2022-2031 e miratuar nga Qeveria në Dhjetor 2022.	Strategjia e Energjisë 2022-2031 dhe Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë të publikuar nga Qeveria

Përgjigja e qëndrueshmërisë së energjisë e ngulitur në Strategjinë kombëtare të Energjisë dhe e përfaqëuar me tranzicionin e gjelbër të sektorit	Nuk është vendosur masa për qëndrueshmërinë e energjisë	Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës 2022 - 2025 e miratuar më 05.09.2023.	Strategjia e Energjisë 2022-2031 e publikuar nga Qeveria
Miratimi i Ligjit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë	Ligji nuk është miratuar ende	Integrimi i dispozitave për qëndrueshmërinë e energjisë në strategjinë e vendit për energjinë	Ligji i publikuar në Gazetën Zyrtare 02.05.2024
Miratimi i koncept dokumentit për rishikimin e Ligjit për Eficiencë të Energjisë	Koncepti dokumenti për Eficiencën e Energjisë është finalizuar	Ligji nr. 08 L-258 për Promovimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë është miratuar nga Kuvendi më 04.04.2024	Koncepti dokumenti i publikuar nga Qeveria
Miratimi i koncept dokumentit për rishikimin e ligjeve në sektorin e energjisë (Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë)	Koncepti dokumenti për rishikimin e ligjeve në sektorin e energjisë i finalizuar	Koncepti dokumenti për Eficiencën e Energjisë i miratuar nga Qeveria në dhjetor 2022.	Koncepti dokumenti i publikuar nga Qeveria
Rishikimi i etiketimit të produktit të eficiencës së energjisë	Nuk është vendosur	Në dhjetor 2026	Korniza e publikuar
Korniza rregullative e plotësuar në lidhje me Draftin/Rregullin për vetëkonsumatorët me Burime të Ripërtëritshme	Korniza aktualisht në konsultim publik	Rregulla për vet-konsumatorët me burime të ripërtëritshme e publikuar në gusht 2023.	Korniza e publikuar në webfaqe të ZRRE-së.
Transpozimi i plotë i Direktivës për performancën energjetike të ndërtesave (2010/ 31/ BE)	Legjislacioni primar aktualisht është në konsultim publik	Ligji nr. 08/L-242 për Performancën Energjetike të Ndërtesave është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 16.05.2024.	Ligji i publikuar në Gazetën Zyrtare 12.06.2024
Miratimi i Strategjisë së Rinovimit të Ndërtesave dhe i Planit Kombëtar për ndërtesat me energji pothuajse zero (NEPZ).	Drafti i Strategjisë për Rinovimin e Ndërtesave ekzistuese dhe pritjet të finalizohet pas miratimit të Strategjisë së Energjisë.	Strategjia e Rinovimit të Ndërtesave do të miratohet në K3_2025 dhe plani për ndërtesa me konsum afër zero të do të publikohet në K3 2026.	Strategjia dhe Planit Kombëtar për Ndërtesa me konsum afër zero i publikuar

Zbatimi i rregullores për certifikimin e performancës energjetike të ndërtesave	Aktualisht nuk lëshohet asnjë certifikatë (Softueri për llogaritjet e energjisë është në përfundim të procedurave të validimit.)	Çertifikatat e para të performancës energjetike në ndërtesa lëshohen në K4 – 2024 ndërsa funksionalizimi i sistemit të certifikimit në vitin 2025	Çertifikatat e lëshuara dhe softueri i funksionalizuar
III. Objektiv: Tranzicioni i Gjellbër			
Masa: Strategjia e tranzicionit të gjellbër (adresimi i çështjeve strukturore)			
Treguesi		Baza	Objekivi (afatshkurtër dhe afatmesëm)
Miratimi i objektivave të klimës dhe energjisë si pjesë e udhërrëfyesit të dekarbonizimit të vitit 2030 dhe siç propozohet nga Komisioni Evropian	Asnjë objektivi i miratuar ende		Objektivat e miratuara dhe publikuara.
Miratimi i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) – Plani i Komunitetit të Energjisë me objektiva ekuivalente me ato të miratuara në Këshillin e Komunitetit të Energjisë në dhjetor 2022	Draft PKEK		PKEK u finalizua dhe u miratua në vitin 2024.
Përgatitja dhe iniciimi i projektit për sistemet e ngrohjes qendrore të BRE në tetë (8) komuna të Kosovës	Studimi përgatitor i fizibilitetit vazhdon deri në mesin e vitit 2023	Finalizimi i studimit të fizibilitetit dhe VNMS për ngrohjen qendrore në tetë (8) komuna përfundon në K3 2024.	Studimi dhe VNMS i publikuar
Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut nëpërmjet integritetit të tregut	Funksionalizimi i tregut të energjisë elektrike një dite para për zonën tregtare të Kosovës dhe bashkimi i tregut me Shqipërinë është realizuar me 1 shkurt 2024.	Funksionalizimi i tregut brenda ditës dhe bashkimi i tregut brenda ditës me Shqipërinë në TM4 2024.	Raportet vjetore të Zyrës së Rregullatorit për Energji, KOSTT dhe ALPEX.
Krijimi i ankandeve konkurruese për të rritur pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë	Nuk ka ankand të vendosur.	Ankandi i parë për ndërtimin e kapacitetit prej 100 MW solar në Kramovik, Komuna e Rahovecit është shpall në vitin 2023 ndërsa me 31.05.2024 është nënshkruar marrëveshja me konzorciumin fitues për	Uebfaqja e ME-së dhe ZRRRE-së

Fleksibiliteti i sistemit të energjisë elektrike	Niveli i kapacitetit rregullues fleksibël: 5 MW	zhvillim të projektit. 170 MWh magazinim me bateri instaluar deri në vitin 2031	Raporti rregulator i energjisë
--	---	--	--------------------------------



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.06/L-079 për Eficiencë të Energjisë, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr.20/145 të datës 7 qershor 2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë të Republikës së Kosovës Nr. 20/145 i datës 07.06.2023, për themelimin e Komitetit Drejtues dhe Koordinues për shqyrtimin e progresit të zbatimit të masave të Planit të Zbatimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike.
2. Pika 1.4 e Vendimit ndryshohet si vijon: në vend të z. Ahmet Ismaili, në Komitetin Drejtues nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, emërohet Driton Hetemi.
3. Pika 1.5 e Vendimit ndryshohet si vijon: në vend të z. Florim Canolli, në Komitetin Drejtues nga Zyra e Kryeministrit emërohet Besa Curri – Limani.
4. Komiteti Drejtues dhe Koordinues përbëhet edhe nga përfaqësues tjerë të Ministrisë së Ekonomisë, si në vijim:
 - 4.1. Aurora Popova,
 - 4.2. Lejla Hasani.
5. Pika 4. e Vendimit Nr.20/145 të datës 07.06.2023 plotësohet si në vijim: Komiteti autorizohet të ri-destinoj mjetet në masat përkatëse sipas nevojës në kuadër të Planit të Veprimt për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike.
6. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit Nr.20/145 të datës 07.06.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 24/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 paragrafit 3. të Ligjit Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Miratohet Strategjia për Zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës dhe Plani i Veprimit 2024-2026.
- Obligohet Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 25/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet Plani i Veprimit i Strategjisë së Sistemit Inteligjent të Transportit (SIT) për Kosovë, për vitet 2024-2026.
- Obligohen institucionet zbatuese të këtij plani, që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të zbatojnë këtë Plan Veprimi, i cili duhet të rishikohet në baza vjetore.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 26/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Metrologjisë.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 27/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19/A të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L-080 dhe Ligjin Nr. 06/L-023, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për kthimin e mjeteve të transferuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës në shumë prej 8.510 € (tetë mijë e pesëqinddhjetë euro).
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga kodi i pranimit të këtyre të hyrave dhe nga llogaria kryesore e BRK dhe kthehen në llogarinë e Ndërmarrjes Shoqërore "Barnatorja Popullore" Ferizaj, me qëllim që ndërmarrja shoqërore të ketë mjete të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat kreditore dhe për të mbuluar shpenzimet e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 28/223
Datë: 09.10.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafit 3. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Vendimin e Qeverisë Nr.29/112 të datës 13 dhjetor 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.03/128 të datës 16 shkurt 2023, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 4,013,779€ (katër milionë e trembëdhjetëmijeshatatëqindeshtatëdhjetenëntë euro), për zbatimin e masës 4 dhe 5 të Planit të Veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike, sipas vendimit të Qeverisë Nr.29/112 të datës 13 dhjetor 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin e Qeverisë Nr. 03/128 të datës 16 shkurt 2023.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, nga nën-programi "Kontigjenca për Energji" me kod 29050, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe ndahen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11313, në kategorinë shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" ndahet shuma prej 3,900.000€ (tre milionë e nëntëqind mijë euro) dhe në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" ndahet shuma prej 113,779€ (njëqindetrembëdhjetë mijë e shtatëqindeshtatëdhjetenëntë euro).
3. Mjetet sipas këtij vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00097) në programin përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 29/223

Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30 paragrafit 3. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 15 paragrafit 1. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për transfer të mjeteve në shumë prej 4,235,000€ (katër milionë e dyqindetridhjetepesë mijë euro), deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të kategorisë së shpenzimeve kapitale të nën-programeve për vitin 2024, për zbatimin e programit në fushën e kulturës dhe sportit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod 207, nga kategoria e shpenzimeve "Shpenzime Kapitalc" nga nën-programet dhe projektet, si në vijim:
 - 2.1 Nga nën programi Arritjet Sportive, me kod 80200, në shumë 4,110,000.00€ (katër milionë e njëqinddhjetë mijë euro) transferi është -19.89% (duke përfshire të gjitha transferet e realizuara në këtë nën program gjatë vitit 2024), nga projektet si në vijim:
 - 2.1.1 Renovimi i palestrave ekzistuese sportive në qendrat regjionale me kod 12423, në shumë prej -250,000.00€ (dyqindepesëdhjetë mije euro);
 - 2.1.2 Palestra sportive në Viti me kod 13454, në shumë prej -150,000.00€ (njëqindepesëdhjetë mijë euro);
 - 2.1.3 Ndërtimi i Fushave të Tenisit në Komuna të ndryshme me kod 14306, në shumë prej -100,000.00€ (njëqind mijë euro);
 - 2.1.4 Palestra Sportive në Zhegër të Gjilanit me kod 14550, në shumë prej -350,000.00€ (treqindepesëdhjetë mijë euro);
 - 2.1.5 Stadiumi Përparim Thaqi, Prizren me kod 15662, në shumë prej -100,000.00€ (njëqind mijë euro);
 - 2.1.6 Fushat ndihmëse me kod 18309, në shumë prej -387,000.00€ (treqindtetëdhjetë shtatëmijë mijë euro);
 - 2.1.7 Renovimi i Stadiumit „Adem Jashari“ Mitrovicë me kod 13391, në shumë prej -253,000.00€ (dyqindepesëdhjetë e tre mijë euro);
 - 2.1.8 Renovimi i Pallatit të Rinisë me kod 18997, në shumë prej -900,000.00€ (nëntëqind mijë euro);

- 2.1.9 Doxhot në qendrat regjionale - Doxho në Prizren me kod 19239, në shumë prej -200,000.00€ (dyqind mijë euro);
- 2.1.10 Ndërtimi i terreneve të hapura sportive në Gjilan me kod 19240, në shumë prej -20,000.00€ (njëzet mijë euro);
- 2.1.11 Parku sportiv në Gjilan me kod 19241, në shumë prej -100,000.00€ (njëqind mijë euro);
- 2.1.12 Doxhot në qendrat regjionale - Doxho në Mitrovicë me kod 19242, në shumë prej -300,000.00€ (treqind mijë euro);
- 2.1.13 Ndërtimi i sallës së mbyllur në fshatin Mogillë, Kllokot me kod 19243, në shumë prej -40,000.00€ (dyzetë mijë euro);
- 2.1.14 Palestra e gjimnastikës në Fushë Kosovë me kod 19244, në shumë prej -60,000.00€ (gjashtëdhjetë mijë euro);
- 2.1.15 Ndërtimi i stadiunit në Hogosht, Kamenicë me kod 19245, në shumë prej -300,000.00€ (treqind mijë euro);
- 2.1.16 Kompleksi Multisportiv në Prishtinë me kod 19321, në shumë prej -250,000.00€ (dyqindpesëdhjetë mijë euro);
- 2.1.17 Palestra Multisportive në Prizren me kod 19322, në shumë prej -100,000.00€ (njëqind mijë euro);
- 2.1.18 Pishina në Deçan me kod 19389, në shumë prej -200,000.00€ (dyqind mijë euro);
- 2.1.19 Shtëpia e shahut në Gjilan me kod 19412, në shumë prej -50,000.00€ (pesëdhjetë mijë euro).

2.2 Nga nën programi "Biblioteka Kombëtare", me kod 90900, shuma prej 125,000 € (njëqindnjëzetepesë mijë euro, transferi është -19.89% (duke përfshirë të gjitha transferet e realizuara në këtë nën program gjatë vitit 2024), nga projekti:


2.2.1 Renovimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, me kod 14227, në shumë prej -125,000.00€ (njëqindnjëzetepesë mijë euro).

3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendimi transferohen në nën-programet dhe kategoritë e shpenzimeve, si në vijim:

- 3.1 Në nën-programin Sportet e Gjëra, me kod 80100, në kategorinë të shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" në shumë prej 1,394,339.00 € (një milion e treqindnëntëdhjetekatër mijë e treqindetridhjetenëntë euro);
- 3.2 Në nën-programin Përkrahja e Kulturës, me kod 80500, në kategorinë të shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" në shumë prej 2,300,000.00€ (dy milion e treqind mijë euro);
- 3.3 Në nën-programin Mbrojtja Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore me kod 815000 në kategorinë të shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" në shumë prej 250,000.00€ (dyqindpesëdhjetë mijë euro);
- 3.4 Në nën-programin Baleti Kombëtar i Kosovës me kod 82100 në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në shumë prej 85,661.00 € (tetëdhjetepesë mijë e gjashtëqindgjashtëdhjetenjë euro);
- 3.5 Në nën-programin Administrata Qendrore, me kod 11307, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në shumë prej 55,000.00 € (pesëdhjetepesë mijë euro);
- 3.6 Në nën-programin Filharmonia e Kosovës, me kod 81900, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime, në shumë prej 150,000.00€ (njëqindpesëdhjetë mijë euro).

4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 30/223
Datë: 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2023, sipas shtojcës së bashkangjitur këtij vendimi.
2. Obligohen të gjitha organizatat buxhetore për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2023.
3. Niveli i zbatimit të rekomandimeve do të monitorohet nga një mekanizëm i cili përcaktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në koordinim dhe me mbështetjen e Zyrës së Kryeministrit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

